

K O N K L U Z I O N
Nr.09-407/1 dt. 01.04.2016
PËR SHPALLJEN E VENDIMIT
PËR ZGJEDHJEN E KOMANDANTIT TË STACIONIT POLICOR TË
KOMPETENCËS SË PËRGJITHSHME DIBËR

518.Në mbështetje të nenit 50 të Ligjit për vetadministrimin lokal (“Gazeta zyrtare e RM” nr.5/02) si dhe nenit 45 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr.14/03),

Kryetari i Komunës Dibër:

K o n k l u d o i

Shpallet vendimi për zgjedhjen e Komandantit të Stacionit policor të kompetencës së përgjithshme Dibër, miratuar nga Këshilli i Komunës në seancën e 34^{të} dt. 31.03.2016.

KOMUNA DIBËR
Kryetari,
Ruzhdi Lata d.v.

519.Në mbështetje të nenit 24 paragrafi 3 të Ligjit për policinë (“Gazeta zyrtare e RM” nr. 114/2006 ,6/2009, 145/2012, 41/2014, 33/2015 dhe 31/2016) nenit 36 paragrafi 1 pika 12 të Ligjit për vetqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e RM” nr.5/2002) si dhe nenit 59 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr. 14/03)

Këshilli i Komunës Dibër në seancën e 34^{të} dt. 31.03.2016 solli:

V E N D I M
PËR ZGJEDHJEN E KOMANDANTIT TË STACIONIT POLICOR TË
KOMPETENCËS SË PËRGJITHSHME DIBËR

1.Për komandant të Stacionit policor të kompetencës së përgjithshme Dibër zgjidhet:

ARGËTIM VOJNIKA nga Dibra.

2.Ky vendim hyn në fuqi ditën e shpalljes në Kumtesën zyrtare të Komunës.

Nr.08-366/3
31.03.2016
D i b ë r

KËSHILLI I KOMUNËS
Kryetari,
Bashkim Mashkulli d.v.

K O N K L U Z I O N
Nr.09-407/2 dt. 01.04.2016
PËR SHPALLJEN E VENDIMIT
PËR ORGANIZIMIN, FUSHËVEPRIMIN DHE MËNYRËN E
USHTRIMIT TË DETYRAVE TË ADMINISTRATËS KOMUNALE NË
KOMUNËN DIBËR

520.Në mbështetje të nenit 50 të Ligjit për vetadministrimin lokal (“Gazeta zyrtare e RM” nr.5/02) si dhe nenit 45 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr.14/03),
Kryetari i Komunës Dibër:

K o n k l u d o i

Shpallet vendimi për organizimin, fushëveprimin dhe mënyrën e kryerjes së detyrave të administratës komunale në Komunën Dibër, miratuar nga Këshilli i Komunës në seancën e 34^{të} dt. 31.03.2016.

KOMUNA DIBËR
Kryetari,
Ruzhdi Lata d.v.

V E N D I M

Nr.08-366/4 dt. 31.03.2016

**PËR ORGANIZIMIN, FUSHËVEPRIMIN DHE MËNYRËN E KRYERJES SË
DETYRAVE TË ADMINISTRATËS KOMUNALE NË KOMUNËN E DIBRËS**

521.Në mbështetje të nenit 57 paragrafi 4 të Ligjit për vetëqeverisje lokale („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 5/02), dhe nenit 17 paragrafi (7) të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik („Gazeta zyrtare e RM, nr. 27/2014 dhe 199/2014) me propozim të Kryetarit të Komunës,

Këshilli i Komunës Dibër, në seancën e 34^{te} datë 31.03.2016 vendosi:

I.DISPOZITA THEMELORE

Neni 1

Me këtë vendim përcaktohet organizimi i mbrendshëm i Komunës Dibër (në tekstin e mëtuftjeshëm: Komunës), llojet dhe numri i njësive organizative, fushëvëprimi dhe mënyra e kryerjes së detyrave të administratës komunale, mënyra dhe format e udhëheqjes, si dhe paraqitja grafike (organogrami) i organizimit të brënshtëm të Komunës.

Neni 2

(1)Administrata komunale e Komunës Dibër kryen punët nga kompetenca e organeve të Komunës, respektivisht Këshillit dhe Kryetarit të komunës.

(2)Administrata komunale:

- kryen punë profesionale për Këshillin dhe Kryetarin e komunës;

-përcjell problematikën në fushat nga kompetenca e Komunës, kryen analiza për gjendjet dhe jep iniciativa dhe propozime për zgjidhjen e tyre ;

-jep informacione dhe të dhëna në lidhje me aktivitetet e Komunës me kërkesë të organeve kompetente ose në bazë të ligjit.

(3)Administrata komunale i kryen punët nga kompetenca e Organeve të komunës në pajtim me Kushtetutën dhe ligjet, me Statutin e komunës dhe me dispozita tjera dhe akte të përgjithshme të miratuara në pajtim me ligj.

Neni 3

Mbi bazën e kompetencave të Komunës, grupimit të punëve dhe detyrave sipas llojit, vëllimit, ndërlikueshmërisë, lidhshmërisë dhe ngjajshmërisë të tyre mes veti, administrata komunale organizohet në sektorë, njësi dhe Njësine territoriale kundër zjarrit.

Neni 4

(1)Sektori formohet me qëllim të bashkimit të më shumë fushave të ndërsjella nga kompetenca e organeve të Komunës, si dhe me qëllim të koordinimit dhe kontrollimit të punëve nga kompetenca e njësive në përbërjen e tij dhe përcjelljen dhe avancimin e bashkëpunimit të ndërsjelle të njësive.

(1)Njësia formohet me qëllim të kryerjes së drejtpërdrejtë të njërës nga punët vijuese: normative-juridike, udhëheqje me resurset njerëzore, punë profesionale-analitike,administruese,administrative- mbikëqyrëse,informative-dokumentuese,informative-komunikuese, profesionale-operative, materiale-financiare, investive, informatike-teknologjike, profesionale-administrative dhe punë tjera që kryehen në Organet e Komunës.

(3)Njësia territoriale kundër zjarrit formohet për mbrojtjen nga zjarri në pajtim me ligj dhe rregullativë tjetër ligjore.

II.LLOJET DHE NUMRI I NJËSIVE ORGANIZATIVE

Neni 5

(1)Administrata komunale organizohet në këto sektorë, njësi dhe Njësinë territoriale kundër zjarrit të Komunës Dibër:

1.Sektori për punë juridike dhe të përgjithshme dhe veprimtari publike:

-Njësia për punë juridike dhe punë të përgjithshme;

-Njësia për veprimtari publike;

2.Sektori për urbanizëm, mjedis jetësor, zhvillim ekonomik lokal, veprimtari komunale, komunikacion dhe rrugë

-Njësia për urbanizëm, mjedis jetësor dhe zhvillim ekonomik lokal;

-Njësia për veprimtari komunale, komunikacion dhe rrugë;

3. Njësia për administrim me resurse njerëzore

4. Njësia për mbikqyrje inspektimi,

5. Njësia për revizion të brenshëm,

6. Njësia territoriale kundër zjarrit,

7. Njësia për çështje financiare.

III.FUSHVEPRIMI I NJËSIVE ADMINISTRATIVE

Neni 6

Sektori për punë juridike e të përgjithshme dhe veprimtari publike kryen këto punë: përgatit akte për Kryetarin dhe Këshillin; përgatit seancat e Këshillit dhe mbledhjen e trupave të tij të punës; kryen punë profesionale për Kryetarin dhe Këshillin; disponon me dokumentat e Komunës dhe i ruan deri në azgjësimin e tyre gjegjësisht dorëzimin Arkivit shtetëror republikan; kryen punë nga fusha e vetqeverisjes vendore dhe mbrojtjes civile; çështjet nga fushën e kulturës, arsimit, mbrojtjes së fëmijëve dhe sportit; kryen dhe punë tjera nga kompetenca e Komunës..

Neni 7

Njësia për punë juridike dhe punë të përgjithshme kryen punët që kanë të bëjnë me: përgatitjen e vendimeve, dispozitave e akteve tjera nga kompetenca e Kryetarit të Komunës dhe Këshillit të Komunës; jep mendim për aktet në aspet të ligjshmërisë së tyre;përcjell dispozitat dhe ndryshimet e plotësimet e tyre, kryen punë profesionale dhe organizative për Këshillin dhe Kryetarin e Komunës, kryen dhe punë tjera që i besohen nga këshilli dhe Kryetari i komunës.

Neni 8

Njësia për veprimtari publike kryen punët që kanë të bëjnë me: punë nga fusha e arsimit, kulturës, mbrojtjes së fëmijëve dhe sportit, mbrojtjes civile, mbrojtjes dhe shpëtimit; kryen dhe punë tjera nga kompetenca e Komunës.

Neni 9

Sektori për urbanizëm, mjedis jetësor, zhvillim ekonomik lokal,veprimtari komunale,komunikacion dhe rrugë kryen punët që janë të lidhura me: planifikimin urbanistik (urban dhe rural), dhënien e lejeve për ndërtim të objekteve më rëndësi lokale të përcaktuara me ligj;rregullimin e hapsirës dhe rregullimin e tokës ndërtimore; mbrojtjen e mjedisit jetësor; masat për mbrojtje dhe pengim të ndotjes së ujit,ajrit, tokës dhe llojit tjetër të ndotjes, realizimin e politikës së zhvillimit ekonomik lokal konform programeve të Këshillit dhe Kryetarit të Komunës; kryen dhe punë tjera nga kompetenca e Komunës të lidhura me urbanistikën, punët komunale, mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe zhvillimit ekonomik lokal.

Neni 10

Nësia për urbanizëm, mjedis jetësor, zhvillim ekonomik lokal kryen punët që kanë të bëjnë planifikimin urbanistik dhe hapsinor në Komunë dhe nismën e iniciativave dhe propozimeve për sjellje dhe ndryshime të Planeve Detale Urbanistike, dhënien e ekstrakteve nga PDU, aktvendime për kushte lokacioni, leje ndërtimi për objekte nga kompetenca e Komunës, punë që janë të lidhura me mbrojtjen dhe avansimin e mjedisit jetësor dhe natyrës, krijon kushte për zhvillim ekonomik lokal kryen dhe punë të tjera nga kompetenca e Komunës.

Neni 11

Nësia për veprimtari komunale, komunikacion dhe rrugë kryen punët që kanë të bëjnë me përcjelljen e gjendjes dhe organizimin e ndërtimit, rekonstruimit, mirëmbajtjes dhe mbrojtjes së gjelbërimit publik, drurëndjeve, fontanave dhe paisjes tjetër komunale të vendosura në rrugët dhe sipërfaqet tjera publike, kujdeset për ndriçimin publik në territorin e Komunës, bën mirëmbajtjen e rrugëve lokale, kryen dhe punë që do ti besohen mbi bazën e Ligjit dhe akteve tjera.

Neni 12

Njësia për menaxhim me resurset njerëzore zbaton kompetencat nga fusha zhvëllimore e Organit, sistemit informativ për resurse njerëzore, marrëdhënieve mes të punësuarve, trajnimeve dhe avansimit, avansimit organizativ dhe punësimit, komunikimit me njësitë tjera me të vetmin qëllim zbulimin e potencialeve njerëzore dhe dhënien e propozimeve për punësim, zhvillim të kulturës organizative në funksion të realizimit të qëllimeve të Organit, propozon politika për menaxhim me resurste njerëzore në Organ.

Neni 13

Njësia për mbikqyrje inspektimi bën mbikqyrje inspektimi mbi kryerjen e punëve nga kompetenca e Komunës në bazë dhe në pajtim me Ligj si dhe koordinon punën e saj me sektorët dhe njësitë në kuadër të administratës komunale.

Neni 14

Njësia për revizion të brendshëm kryen revizion të brendshëm në pajtim me Ligjin dhe sistemin e procedurave për revizion të brendshëm të vendosura nga Komuna në pajtim me standardet ndërkombëtare për punë profesionale të revizionit të brendshëm të përkrahura nga Ministra e Financave;

- përgatit planin vjetor për revizionin e brendshëm dhe pas miratimit nga Kryetari i Komunës, e siguron zbatimin dhe përcjelljen e saj,
- jep raporte Kryetarit të Komunës dhe Këshillit të Komunës për revizionet e kryera;
- përgatit planet vjetore dhe strategjike për punën e revizionit të brendshëm;
- bën vlerësimin e faktorëve të rëndësishëm gjatë rrezikut dhe i jep këshilla Kryetarit për uljen e faktorëve të rrezikut;
- në bazë të analizave e vërteton dhe e vlerëson ekonomizimin, efikasitetin dhe efektivitetin e punës së sistemeve për kontrollimin dhe menaxhimin financiar dhe jep rekomandime për përmirësimin e punës së administratës komunale;
- përcjell dhe bën kontrollimin e saktësisë dhe kompletimin e evidencës së kontabilitetit dhe raporteve financiare,
- vërteton dhe vlerëson harmonizimin e punës me ligjet, aktet nënligjore të komunës.

Neni 15

Njësia territoriale kundër zjarrit i kryen këto punë:

- Shuarjen e zjarreve në territorin e Komunës,
- mënjanimin e rrezikut të drejtpërdrejtë për shkaktimin e zjarrit;
- shpëtimin e jetës së qytetarëve dhe mbrojtjen e pronës së rrezikuar nga zjarri dhe eksplozimet;
- dhënien e ndihmës teknike gjatë lëndimeve dhe situatave të rrezikshme,

- kryerjen e punëve tjera gjatë fatkeqësive;
- kryen shërbime joprofitabile për shkak të përmirësimit të pajisjes teknike dhe kushteve për punë, të cilat nuk e mundësojnë ose pengojnë kryerjen e funksionit;
- së bashku me Njësitë territoriale zjarrfikëse në RM të përcaktuara me ligj, veprojnë si njësi zjarrfikëse në Republikën e Maqedonisë për shkak të ndikimit operativ gjatë shuarjes së zjarreve të mëdha në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë,
- dhënien e ndihmës kur ajo është kërkuar gjatë shuarjes së zjarreve në shtetet tjera,
- mbajtjen e evidencës së veçantë për zjarret e shkaktuara, eksplozimet, intervenimet për shuarje dhe intervenimet për ngjarje tjera sipas metodologjisë së vetme dhe lajmërimit për Drejtorinë për mbrojtje dhe shpëtim dhe Komunën e Dibrës për një gjë të tillë,
- kontrollim periodik të rregullshmërisë së pajisjes zjarrfikëse me të cilën disponon Njësia territoriale kundër zjarrit;
- kontroll dhe mirëmbajtje e përditshme e paisjeve;
- dhënie të sigurimit zjarrfikës objekteve, delegacioneve, tubimeve publike, aktiviteteve sportive dhe manifestimeve tjera, në koordinim me Ministrinë për Punë të Brendshme;
- edukim të qytetarëve për mbrojtje nga zjarri me ligjerata të organizuara, nëpërmjet mediave si dhe organizimit të aktiviteteve tjera;
- kryen dhe punë tjera që do t'i besohen.

Neni 16

Njësia për çështje financiare kontrollon zbatimin e udhëheqjes dhe kontrollit financiar, kryen eks-ante dhe eks-post kontroll financiar, punët e arkës, punët rreth përgatitjes, pranimit, likuidimit dhe kontrollë të dokumentacionit të kontabilitetit, llogaritjen e rrogave të punëtorëve të subjektit, përcjell vjeljen me kohë dhe të plotë të të hyrave, përcjell pagesat me afat të shpenzimeve në pajtim me procedurat për marrjen e obligimeve dhe realizimeve të pagesave , përgatit plan strategjik dhe propozimbuxhetin për vitin që pason si dhe projeksionet shumëvjeçare lidhur me buxhetin, përcjell harmonizimin e realizimit të buxhetit të plotë ose disa zërave të veçanta me procedurat e miratuara nga udhëheqësi i subjektit, përgatit propozim për ndryshim dhe plotësim të buxhetit, llogarisë përfundimtare të Komunës, përgatit raport vjetor financiar në pajtim me Ligjin për kontrollë publik të brënjshëm financiar , mban evidencë për pronën e Komunës, përcaktimin dhe pagesën e tatimeve, taksave dhe kompensimeve që paraqesin të ardhura të komunës, kryen dhe punë tjera nga fusha e administrimit dhe kontrollës financiare.

IV.MËNYRA DHE FORMA E UDHËHEQJES ME PUNËT

Neni 17

Me komunën dhe administratën komunale udhëheq Kryetari i komunës i cili siguron kushte për zbatim efikas të ligjeve dhe akteve tjera që kanë të bëjnë me marrëdhëniet e punës të nëpunësve administrativ dhe të punësuarve tjerë, miraton aktin e sistematizimit të vendeve të punës si dhe sjell plane vjetore për punësim.

Me sektorin udhëheq udhëheqësi sektorit, e në rast të mungesës ose pengesës në punë e zëvendëson njëri nga udhëheqësit e njësive të atij sektori.

Me njësinë udhëheq udhëheqësi i njësisë, e në rast të mungesës ose pengesës në punë, me njësinë udhëheq një nga nëpunësit profesionist me titullin më të lartë që ai do të përcaktojë.

Me Njësinë territorijale kundër zjarrit komandon Komandanti e në rast mungese ose pengese në punë me NJTKZ komandon udhëheqësi i grupit.

Neni 18

Numrin e përgjithshëm të të punësuarve dhe sistemimin sipas titujve dhe vendeve të punës e përcakton Kryetari i komunës me Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në Komunë.

V. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËFUNDIMTARE

Neni 19

Ky vendim mund të ndyshohet dhe plotësohet në mënyrën dhe procedurën e njëjtë të sjelljes.

Neni 20

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi pushon të vlejë Vendimi për organizimin, fushëveprimin dhe mënyrën e realizimit të detyrave të administratës komunale të komunës Dibër nr. 07-715/4 dt. 30.06.2010, dhe vendimi për ndryshim dhe plotësim të vendimi për organizimin, fushëveprimin dhe mënyrën e realizimit të detyrave të administratës komunale të komunës Dibër nr. 07-88/8 dt. 03.02.2012.

Neni 21

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljen në “Kumtesën zyrtare të Komunës” dhe do të aplikohet pas marrjes së pëlqimit nga ana e Ministrisë për shoqëri informative dhe administratë.

KËSHILLI I KOMUNËS
Kryetari,
Bashkim Mashkulli d.v.

K O N K L U Z I O N
Nr.09-407/3 dt. 01.04.2016
PËR SHPALLJEN E PËRFUNDIMIT PËR SJELLJEN E PROGRAMIT
PËR RREGULLIMIN E TOKËS NDËRTIMORE
NË TERRITORIN E KOMUNËS DIBËR PËR v.2016

522.Në mbështetje të nenit 50 të Ligjit për vetadministrimin lokal (“Gazeta zyrtare e RM” nr.5/02) si dhe nenit 45 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr.14/03),

Kryetari i Komunës Dibër:

K o n k l u d o i

Shpallet përfundimi për sjelljen e Programit për rregullimin e tokës ndërtimore në territorin e Komunës Dibër për vitin 2016, miratuar nga Këshilli i Komunës në seancën e 34^{të} dt. 31.03.2016.

KOMUNA DIBËR
Kryetari,
Ruzhdi Lata d.v.

P Ë R F U N D I M
Nr. 08-366/5 dt. 31.03.2016
PËR SJELLJEN E PROGRAMIT
PËR RREGULLIMIN E TOKËS NDËRTIMORE
NË TERRITORIN E KOMUNËS DIBËR PËR v.2016

523.Në mbështetje të nenit 36 paragrafi 1 pika 15 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale („Gazeta Zyrtare e RM,, nr.5/02) si dhe nenit 59 të Statutit të komunës („Kumtesa Zyrtare e Komunës,, nr 14/03),

Këshilli i Komunës Dibër në seancën e 34^{të} datë 31.03.2016 përfundoi:

1.Këshilli i Komunës Dibër sjell Programin për rregullimin e tokës ndërtimore në territorin e Komunës Dibër për vitin 2016.

2.Programi nga pika 1 është pjesë përbërëse e Përfundimit.

3.Ky përfundim hyn në fuqi një ditë pas shpalljen në “Kumtesën zyrtare të Komunës”

KËSHILLI I KOMUNËS
Kryetari,
Bashkim Mashkulli d.v.

524.Në mbështetje të nenit 36 të Ligjit për vetadministrimin lokal (“Gazeta zyrtare e RM” Nr. 5/02) si dhe nenit 44 paragrafi 1 pika 7 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës” nr. 14/03), në lidhje me nenin 84 të Ligjit për tokën ndërtimore (“Gazeta zyrtare e RM” nr. 17/11, 53/11, 144/12, 25/2013, 137/2013, 163/13, 44/15, 193/15, 226/15 dhe 30/16), në pajtim me Rregulloren për shkallën e rregullimit të tokës ndërtimore me objekte të infrastrukturës komunale dhe mënyrën e përlogaritjes së shpenzimeve për rregullimin e tokës ndërtimore sipas shkallës së rregullimit (“Gazeta zyrtare e RM” nr.93/11, 65/12, 75/12, 98/12, 133/13, 155/13,96/14,107/14,115/14 dhe 149/14).

Këshilli i komunës Dibër në seancën e 34^{të} dt 31.03.2016 solli:

PROGRAM
Për rregullimin e tokës ndërtimore për
komunën e Dibrës për vitin 2016

Me programin për rregullimin e tokës ndërtimore të komunës së Dibrës për vitin 2016 parashifet realizimi i punëve nga sfera e rregullimit të tokës ndërtimore dhe paisjen e tokës ndërtimore me objekte komunale dhe instalime.

Investimet në rregullimin e tokës ndërtimore janë të parapa të jenë në funksion të realizimit të planeve urbanistike dhe dokumenteve tjera planore.

Periudha planifikuese dhe programore për rregullimin e tokës ndërtimore paraqet pjesë të politikës së përcaktuar të Komunës në fushën e ndërtimeve komunale, instalimeve dhe ndërtimeve tjera në suazat e të drejtave dhe obligimeve sipas Ligjit për planifikimin hapsinor dhe urbanistik, Ligjit për tokën ndërtimore si dhe dispozitave tjera që e rregullojnë këtë lëmi.

Programi për rregullimin e tokës ndërtimore përmban këto elemente:

- I. Territorin ku do kryhet rregullimi i tokës:*
- II. Vëllimin e rregullimit të tokës ndërtimore dhe shkallën e paisjes me objekte komunale dhe instalime.*
- III. Burimet për rregullimin e tokës ndërtimore.*
- IV. Llogaritjen e shpenzimeve për rregullimin e tokës ndërtimore.*
- V. Mënyrën e grumbullimit dhe shpenzimit të mjeteve dhe*
- VI. Dinamikën e realizimit të Programit.*

I.TERRITORI KU DO TË KRYHET RREGULLIMI I TOKËS
NDËRTIMORE

Territori ku do të bëhet rregullimi përcaktohet toka ndërtimore e ndërtuar dhe toka ndërtimore e pandërtuar e përfshirë me Planin Gjeneral Urbanistik, Planet Detale Urbanistike të qytetit, për vendbanimet për të cilat ka dokumentacion urbanistik për vendbanime rurale, Plane Urbanistike për fshat, Plane Urbanistike jashta vendbanimit. Rregullimi do të realizohet në harmonizim me nevojat për ndërtim të objekteve për banim, atyre ekonomike, objekteve tjera komunale dhe të infrastrukturës, duke rrajuar kështu kontinuitetin e ndërtimit nga periudha e kaluar.

Gjatë vitit 2016 me Programin për rregullimin e tokës ndërtimore do të përfshihen disa territore dhe lokalitete në qytetin Dibër dhe vedbanimet rurale të komunës dhe ate:

- Lokalitetet në të cilat do të kryhen obligimet nga periudha e kaluar.
- Lokalitetet në të cilat do të ndërtohen objekte të reja komunale.

Gjatë vitit 2016 rregullimi i tokës ndërtimore do të kryhet në lidhje me ndërtimin e objekteve për banim kolektiv, objekteve për banim individual, objekteve afariste si dhe objekteve tjera me interes të përgjithshëm.

1. OBJEKTE PËR BANIM KOLEKTIV

Ndërtimi i objekteve për banim kolektiv do të realizohet në sipërfaqe të përcaktuara për këtë qëllim me planin urbanistik të qytetit të Dibrës.

Lokalitetet orientuese për ndërtim të objekteve për banim kolektiv:

- Lagje “Venec 2” ,
- Objektet banuese në rr. “8-të Shtatori”,
- Objektet banuese më rr. “Velko Vllahoviq”,
- Objektet banuese në rr. “22 Dhjetori” dhe
- Objektet banuese në pjesët tjera të qytetit sipas planit urbanistik.

2.OBJEKTE PËR BANIM INDIVIDUAL

Ndërtimi i objekteve për banim individual do të parashihet gjatë tërë rajonin urbanistik, nëpër sipërfaqet e përcaktuara për këtë qëllim sipas planit urbanistik të qytetit të Dibrës.

Lokalitetet orientuese për ndërtim të objekteve për banim individual:

- Lagja “Venec-2”
- Lagja “Qeranice”
- Pjesët tjera të qytetit dhe vedbanimeve rurale

3.NDËRTIMI I OBJEKTEVE AFARISTE DHE PRODHUESE

Ndërtimi i objekteve afariste do të kryhet në sipërfaqet e parapara për këtë qëllim në bazë të planit urbanistik të qytetit të Dibrës.

Lokalitetet orientuese për ndërtim të abjekteve afariste:

- Lokacini i ish gazermës Liman Kaba,
- Objekte afariste në lokalitete tjera në qytet, në kuadër të objekteve banuese-afariste,
- Lokaliteti “Hyrja Lindore”
- Objekte afariste në vedbanime rurale
- Zgjerime (anekse) dhe mbindërtime të objekteve ekzistuese afariste

4.NDËRTIMI I OBJEKTEVE ME INTERES TË PËRGJITHSHËM

Objektet me interes të përgjithshëm do të ndërtohen në sipërfaqet e parapara për ndërtime të tilla në bazë të planit urbanistik.

Për ç'do lokalitet konkret për rregullimin e tokës ndërtimore sipas Programit, do të përgatiten zgjidhjet e situatave, elaboratet gjeodezike, zgjidhjet për rregullimin e tokës rreth objektit, mënyrat e lidhjes në objektet komunale.

II.VËLLIMI I RREGULLIMIT DHE SHKALLA E PAISJES SË TOKËS NDËRTIMORE ME OBJEKTE KOMUNALE DHE INSTALIME

Vëllimi i rregullimit dhe shkalla e paisjes të tokës ndërtimore me objekte komunale dhe instalime do të realizohet suksesivisht, sipas dinamikës të ndërtimit dhe sigurimit të mjeteve financiare për rregullimin e tokës ndërtimore.

Përgatitja dhe paisja e tokës ndërtimore me objekte komunale dhe instalime do të kryhet në suazat e mjeteve disponuese, në pajtim me kushtet dhe mundësitë teknike duke marrë parasysh sigurimin e kushteve optimale për funksionimin e objekteve të ndërtuara.

Përgatitja e tokës ndërtimore përfshin:

- Përpilimin e planeve urbanistike,
- Sigurimin e dokumentacionit gjeodezik, elaborateve,
- Përpilimin e dokumentacionit teknik-investues.
- Zgjidhjen e marrëdhënjeve pronësore juridike me pronarët e tokës,
- Heqjen, dislokimin e objekteve komunale ekzistuese të cilat paraqesin pengesë gjatë ndërtimit dhe shfrytëzimit të objektit,
- Shkatërimin e objekteve dhe transportimin e mbeturinave deri në deponi.
- Rafshimin e truallit (që nënkupton rafsimin e truallit me kuotën e konfiguracionit natyral të vendit),
- Pastrimin e vendit nga mbeturinat e ndryshme.

Paisja e tokës ndërtimore me objekte komunale dhe instalime :

a) Paisjen e tokës ndërtimore me objekte themelore të infrastruktures që hynë në llogari të komunes:

- Ndërtimi i rrugëve dhe trotuareve,
- Ndërtimi sistemeve dhe rrjetet të usjellësve,
- Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit fekal dhe atmosferik.
- Gjelbrimi i sipërfaqeve publike, mirmbajtja e parqeve dhe sipërfaqeve të gjelbërta
- Ndërtimi dhe mirëmbajtje e nriçimit publik,
- Vendosja e paisjeve urbane,
- Mirmbajtje e përmendoreve

Me këtë Program nuk parashikohet ndërtim i rrjetit shpërndarës elektrik dhe transformatorëve, ndëtimi i PTT dhe rrjetet tjera kablore si dhe kycja në ta, që do të thotë se financimet e këtyre objekteve, gjegjësisht ndërtimin e tyre do ta bëjnë ndërmarjet që menaxhojnë me ato, në marrëveshje me investuesit.

b) Objektet komunale dhe instalimet që hynë në llogari të investuesit:

- Lidhja në rrjetin sekundar të ujit dhe ujrave të zeza sipas kushteve hidroteknike,
- Lidhja më rrjetin sekundar të tensionit të ulët sipas kushteve elektroenergjetike (në shtyllë ose kuti shpërndarëse)
- Rregullimi i parterit-vendit rreth objektit sipas projektit të përgatitur, hyrjet prej rrugës në objekt.
- Rrjeti ujqor-hidrante për mbrojtjen nga zjarri dhe vaditjen e gjelbërimit mbrenda lokacionit,
- Ndriçimi lidhur me objektin dhe sipërfaqet brenda lokalitetit,
- Ndërtimi i mureve mbrojtëse, gjelbërimi i vendit, rrethimi i objektit ejt.

III.BURIMET PËR RREGULLIMIN E TOKËS NDËRTIMORE

Mjetet për mbulesë të shpenzimeve reale për rregullimin e tokës ndërtimore sigurohen nga:

Kompenzimi për rregullimin e tokës ndërtimore.

Vetëkontributi qytetar,

Fonde dhe donacione të ndryshme

IV.LLOGARITJA E SHENZIMEVE PËR RREGULLIMIN E TOKËS NDËRTIMORE

1. KOMPENSIMI PËR RREGULLIMIN E TOKËS NDËRTIMORE:

Lartësia e kompensimit për rregullimin e tokës ndërtimore mvaret nga llojit (destinimit) të objektit dhe llojit të ndërtimit zona ku ndërtohet objekti të percaktuara me këtë Program,.

Për rregullimin e tokës ndërtimore investuesit të cilët ndërtojnë objekte do të paguajnë kompensim në lartësinë e caktuar me këtë Program, e cila llogaritet për m² neto sipërfaqe shfrytzuese nësecilin kat të objektit që ndërtohet sipas dokumentacionit projektus të verifikuar.

Në sipërfaqe shrytëzuase nuk llogoriten sipërfaqet nën mure dhe pjesë tjeta konstruktive, kanalet e instalimeve, kafazet e ashensorëve, hapjet e dyerve dhe parkingjet e hapura.

Lartësia e komensimit për rregullimin e tokës ndërtimore, varësisht prej zonës ndërtimore, llojit dhe qëllimit të objektit, shumzuar me koeficientet të percaktuar me Rregulloren per shkalln e rregullimit të tokës ndërtimore dhe mënyrës së përlllogaritjes të shpenzimeve për rregullimin e tokës ndërtimore sipas shkallës të rregullimit është:

Për qytetin e Dibrës:

Lloji i objektit	Zona e parë Den/m2	Zona e dytë Den/m2
1. Objekte banimi (individual dhe kolektiv)	1980,00	1.380,00
Hapsira banimi	Koeficient 1.0	Koeficient 1.0
Hapsira banimi me lartësi deri 2.5m, hapsirë nënkulmi	Koeficient 0.2	Koeficient 0.2
Ballkon i mbyllur në 3 anë	Koeficient 0.4	Koeficient 0.4
Ballkon i mbyllur në 2 anë	Koeficient 0.3	Koeficient 0.3
Balkone idhe terasa	Koeficient 0.2	Koeficient 0.2
Terasa te perbasheta përdhese dhe pasazhe	Koeficient 0.2	Koeficient 0.2
Hapsira ndihmëse, depo për lendë djegse, kaldaja, bodrum	Koeficient 0.3	Koeficient 0.3
Transformator deri 35 Kv mbenda apo jasht objektit	Koeficient 0.3	Koeficient 0.3
Hapsira e shkallëve dhe komunikim i përbashkët	Koeficient 0.3	Koeficient 0.3
Hapsirat për rrojtat, menaxhim dhe mirmbajtje	Koeficient 0.5	Koeficient 0.5
Parkingje dhe garazha	Koeficient 0.1	Koeficient 0.1
2. Objekte afariste dhe publike	3.900,00	2.900,00
Hapsirat	Koeficient 1,0	Koeficient 1,0
Magacin	Koeficient 0.5	Koeficient 0.5
Hapsira ndihmëse, depo per lendë djegse, kaldaja, bodrum	Koeficient 0.3	Koeficient 0.3
Transformator deri 35 Kv mbenda apo jasht objektit	Koeficient 0.4	Koeficient 0.4
Hapsira e shkallëve dhe komunikim i përbashkët	Koeficient 0.5	Koeficient 0.5
Parkingje dhe garazha	Koeficient 0.1	Koeficient 0.1
Ballkon i mbyllur në 3 anë	Koeficient 0.5	Koeficient 0.5
Ballkon i mbyllur në 2 anë	Koeficient 0.3	Koeficient 0.3
Balkone idhe terasa	Koeficient 0.4	Koeficient 0.4
Hapsire e hapur e mbuluar	Koeficient 0.3	Koeficient 0.3
3.Objekte tjera	3.300,00	2.400,00
Garazhe në kate	Koficient 0,05	Koficient 0,05
Objekte sportive të mbuluara	Koficient 0,5	Koficient 0,5
Objekte sportive të pa mbuluara	Koficient 0,3	Koficient 0,3
Qendra te gazit, dhe qendra të bazave të ndyshme (për 50 % të sipërfaqes të lokacionit)	Koficient 1,0	Koficient 1,0
Tregje të hapura (për 30 % të sipërfaqes të lokacionit)	Koficient 1,0	Koficient 1,0
Pishina	Koficient 0,2	Koficient 0,2
Transformatorë mbi 35 Kv (1)	Koficient 1,0	Koficient 1,0
Për agro berza , qendra grubullimi dhe distribuimi ose tregje (miret 50% e sipërfaqes së përgjithshme të llogaritur)	Koficient 1,0	Koficient 1,0
4. Objekte për prodhim, shperndarje dhe	12.000,00	10.000,00
G-1 Industri e rëndë ndotëse	Koficient 0,05	Koficient 0,05
G-2 Industri e lehtë jodotëse	Koficient 0,05	Koficient 0,05
G-3 Servisim	Koficient 0,05	Koficient 0,05
G-4 Depo magazinimi- ngakim sharkim	Koficient 0,05	Koficient 0,05
5. Stacion pompe benzini dhe permbajtjet e saja përciellëse (shitore, kafiteri dhe retorante, auto servis, auto sallon hapsira ndihmëse)	3.900,00	2.900,00
Hapsirat shitëse të stacionit për pompë benzini	Koficient 1,0	Koficient 1,0
Hapsirat ndihmëse të stacionit për pompë benzini	Koficient 1,0	Koficient 1,0
6.Koplekse turistike hoteljrike, komplekse hoteljrike dhe pushimore (B-5), hotel, motel, shëpi për alpinizëm dhe shëpi për gjueti (A-4)	25.000,00	20.000,00
Per te gjitha hapsirat	Koficient 0,05	Koficient 0,05

Për venbanimet rurale:

Venbanimi	Për objekte banimi per neto sipërfaqe shrytëzuese den/m2	Për objekte publike dhe prodhuese për neto sipërfa shfyts. den/m2
Kategoria 1 vedbanimeve rurale:Kosovrasti i Poshtëm, Bannisht dhe Rajçicë	450,00	600,00
Kategoria 2 vedbanimeve rurale: Mogorçë, Otishan, Xhepistë dhe Gari	300,00	450,00
Kategoria 3 vedbanimeve rurale: Osoj, Ame, Kosovrasti i epërm, Krifcë dhe fshatrat te tjera ne teritorjen te komunes Diber.	100,00	150,00

Për zonat (teritoret) në rajonin ndërtimor dhe jashta tij, ku Komuna Dibër nuk është në gjendje të sigurojë rregullim të tërësishëm të tokës ndërtimore sipas vëllimit dhe shkallës së paraparë për paisjen e tokës ndërtimore me objekte komunale dhe instalime, investitorët do të paguajnë kopezimin me përqindje si vijon:

Punë përgatitore	10%
Për rrugë publike, trotuare	45%
Ujesjells kryesor, rezervoar dhe pastrim (filtrim)	15%
Rrjeti i ujsellsit rrugor	10%
Për rrjetin e kanalizimit fekal	15%
Për sistemin e kolektorëve dhe kanalizimin atmosferik	5%

Në kompezimin për rregullimin e tokës ndërtimore nuk janë llogaritur si të hyra sigurimi (ndërtimi) i energisë elektrike nga rrjeta shpërndarëse dhe transformatori, ndërtimi i rrjetit të PTT dhe rrjet tjetër kablovik, ndërtimi i qndrave për pasrim të ujrave fekal si dhe kopezimi për kuçjen në infrastrukturë në përgjithsi (elektrik, PTT, ujsjellës dhe kanalizim), që do të thotë se këta shpenzime do të jen obligim i investitorëve që ndërtonë objektet.

- Kompensimet për rregullimin e tokës ndërtimore për zgjerimin (anekse) dhe mbindërtime të objekteve ekzistuese është 50 % nga vlera e caktuar, varësisht nga zona në të cilën bëhet zgjerimi ose mbindërtimi.

- Investuesit të cilët rënojnë objektet afariste ose banuese ekzistuese dhe në vendin e tyre ndërtojnë të reja, për sipërfaqet ekzistuese të objektit të vjetër do të paguajnë 30 % të kompensimit në varësi nga zona ku gjendet objekti-përderisa për tejkalimet e sipërfaqeve të objektit të vjetër deri 50 % do të paguhet 50 % e kompezimit e mbi këtë do të paguhet kompensimi i plotë i paraparë sipas Programit.

- Gjatë rindërtimit, me të cilin sipërfaqet afariste apo banimore mbesin të njejta me siërfaqet ekzistuse, investitorët do të paguajnë kompezim për rregullimin e tokës ndërtimore në lartësinë 30 % nga shuma e paraparë me program.

- Nëse gjatë ndërtimit investuesit dalin jashtë dokumentacionit teknik dhe fitojnë sipërfaqe afariste ose banimi më të madhe, janë të obliguar që të paguajnë

diferencën e kompensimit për rregullimin e tokës ndërtimore për sipërfaqen e re, pas marrjes së dokumentacionit të rregullt nga organi kompetent.

- Për suteran do të paguhet 75 % nga shuma e caktuar me këtë Program.

- Investuesit që do të marrin pëlqim nga organi kompetent për ridestinimin e sipërfaqeve do të paguajnë ndryshimin e kompensimit për rregullimin e tokës ndërtimore, varësisht se për çfarë ridestini bëhet fjalë në pajtim me Programin që është në fuqi në momentin e ndryshimit.

- Të drejtat dhe obligimet reciproke për rregullimin e tokës ndërtimore do të caktohen me kontratë ndërmejt ndërtuesit dhe Komunës Dibër.

-Organizatrat publike janë të obliguara që para se të bëjnë kyçjen e objektit në rrjetin elektrik, të ujit dhe telefonik, paraprakisht të kërkojnë leje ndërtimi për objektin.

-Për lokacionet ku shpenzimet për rregullimin e tokës ndërtimore janë më të larta nga ata që janë përcaktuar me program, pjesëmarrja e investuesve në rregullim do të bëhet sipas shpenzimeve reale.

-Me kontratë të veçantë me të cilën do të përcaktohen punët që do të realizohen mundet investuesit t'i lejohej që vetë të bëjnë rregullimin e tokës ndërtimore. Në këtë rast kompensimi për rregullimin e tokës ndërtimore do të paguhet vetëm për investimet e bëra në infrastrukturën primare dhe hartimin – përpilimin e planeve urbanistike.

- Për pagesën e mjeteve për rregullimin e tokës ndërtimore, jepet mundësia e pagesës në këste. Investuesit janë të obliguar që me rastin e nënshkrimit të kontratës të paguajnë 50 % të shpenzimeve për rregullimin e tokës ndërtimore, ndërsa për diferencën të sigurojë garancionin bankor.

Përcaktimi i zonave për rregullimin e tokës ndërtimore

Toka ndërtimore në të cilën do të bëhet rregullimi sipas planit urbanistik të qytetit të Dibrës është i ndarë në dy zona: ZONA E I- rë dhe ZONA E II-të. ndërsa vendanimet rrurale ndahen në 3 kategori.

Zonat e qytetit:

ZONA E PARË: Pjesa e qytetit me lagjet “Venec I“, “Venec II“ dhe “Qenanica”.

Zona e parë fillon nga udhëkryqi i paraparë në hyrje të qytetit (rruga Dibër-Shkup) vazhdon nëpër rrugën e paraparë nëpër kufijtë e lokaliteteve të Kombinatit të gjipsit “knauf-radika” deri te bashkimi me rrugën “1 Maji”, vazhdon nëpër të njejtën deri te bashkimi me rrugën “APJ”, kthen djathtas vazhdon nëpër të njejtën deri te rr.”Ibe Palikuqi”, kthen majtas vazhdon nëpër rr. “Ejup Qatipi” deri te lidhja me rr. “Petre Popovski” te Banja e vjetër e qytetit, vazhdon nëpër të njejtën deri te bashkimi me rr. “22 Dhjetori”, kthen djathtas vazhdon deri te lidhja me rr. “Shkupi”, kthen majtas dhe vazhdon nëpër të, kthen majtas te ish objektet e Armatës, vazhdon nëpër të dhe bashkohet me rr. “8-të Marsi” (rruga e paraparë e kolektorit në pjesën perëndimore), bashkohet në të njejtin drejtim me rr. e “bagëtime”, lëviz nëpër të njejtën deri te bashkimi me rr. “Strugë-Dibër”, vazhdon nëpër të përgjatë bregut të liqenit të Dibrës deri te kryqëzimi me rrugën e paraparë, kthen majtas vazhdon nëpër të deri te bashkimi me rr. Regionale Dibër – Shkup dhe prej aty në pikën fillestare.

Në zonën e parë hynë dhe zonat për gjatë bregut të liqenit të Dibrës, kufijtë e të cilit fillojnë nga udhëkryqi i paraparë në hyrje të qytetit rr. Dibër-

Shkup, lëviz nëpër rrugën e paraparë deri te kryqëzimi me rrugën e kolektorit (rruga Dibër Strugë), kthen majtas deri te bregu i liqenit të Dibrës, lëviz nëpër të deri te kufijtë e KK Rajçicë dhe mbyllet me rrugën regjionale drejtimi Dibër-Shkup.

ZONA E DYTË: Kjo zonë përfshin pjesën tjetër të qytetit deri te kufijtë e planit urbanistik të qytetit të Dibrës, dhe venbanimi Rajçicë ne kuadër të kufirit të Planit Gjeneral Urbanistik të qytetit.

Përcaktimi kategorive të venbanimeve rurale për rregullimin e tokës ndërtimore

- Kategoria 1 e vedbanimeve rurale: Kosovrasti i Poshtëm, Banisht dhe Rajçicë

- Kategoria 2 e vedbanimeve rurale: Mogorçë, Otishan, Zepishtë dhe Gari

- Kategoria 3 e vedbanimeve rurale: Osoj, Ame, Kosovrasti i Epërm, Krifcë dhe fshatrat tjera në territoret të Komunes Dibër.

2.MJETE NGA VETKONTRIBUTI QYTETAR, FONDE DHE DONACIONE

